



IRDK info

Nr.011/14
Fletushkë informative mujore
Mars, 2014



Është ndarë nga jeta veprimtari i shquar Imer Alijaj



FORUMI I EGJIPTIANËVE TË BALLKANIT
BALKAN EGYPTIANS FORUM

Forumi i Egjiptianëve të Ballkanit



Sqarim për Opinionin Publik



Imer Alija
“Shtjellim i emrit IRDK”



Partitë tona në luftë për deputetin e rezervuar

Sikur herëve tjera, edhe tani nuk mund të jem indiferent ndaj zhvillimeve të fundit. Tash e kemi edhe një parti, dhe sado që mundohem të jem i pa anshëm, është e kot, sepse unë jam pjesë e IRDK-së, ndërsa po dua të flas për rrethanat e krijuara pas formimit të një partie të re. Po mundohem të jem i paanshëm. Se a kemi pas nevojë për një parti të re politike apo jo, kjo do të shihet pas përfundimit të zgjedhjeve. Se a ka pas vend të veprohet brenda IRDK-së, unë them po, prandaj edhe jam në IRDK. Ndryshimi i Ligjit Zgjedhor e nxori në skenë edhe një parti e cila do të garoj për vendin e rezervuar në Parlamentin e Kosovës.

Nuk ka asgjë të keqe nëse do të zhvillohet garë për vendin e rezervuar, por nuk është e drejtë që lufta për deputetin e rezervuar të interpretohet ndryshe.

- Pakënaqësia në Kosovë është e pranishme te të gjithë, edhe te populli i jonë. Unë mund t'i numëroj më shumë se 1000 pakënaqësi, dhe po të isha deputet vetëm 10 prej tyre do të merrja përsipër që të mundohem t'i zgjedh. Ata që kanë shumë dëshirë të bëhen deputet, nuk është e sinqertë të konstatojnë se 1000 pakënaqësitë e juaja është dashur t'i zgjidh deputeti aktual, ose të hy borxh me 1000 probleme në këmbim të votave. Situata e popullit tonë është delikate, prandaj ata që rrahin gjoks se do t'i zgjedhin 1000 problemet tona, unë atyre nuk iu besoj.

- Unë qëndrova afër me kryetarin e IRDK-së, dhe me mundësitë e mia i ndihmova. Këtë e bëra për shkak se kisha dëshirë dhe vullnet që të kontribuoj për çështjen e popullit tim dhe për shkak se Xhevdet Neziraj tregonte zotësi dhe autoritet për përfaqësim të dinjitetshëm të popullit tonë në Parlamentin e Kosovës. Me siguri se ka njerëz më të mençur se deputeti Xhevdet Neziraj, më të mençur se unë etj. por Xhevdet Neziraj ishte deputeti më aktiv në radhët e komuniteteve pakicë. Unë nuk do të paraqitesha më mirë në Parlamentin e Kosovës, për të tjerët nuk e di. Puna e deputetit është e lakmueshme sepse mund të jesh deputet për katër vite e mos me thanë asnjë fjalë. Nuk ishte aspak e mirë që IRDK qëndroj në opozitë, sepse çështjet e caktuara kanë qenë vështirë të zgjidhen. Nuk duhet me i hy në hak askujt, Xhevdet Neziraj- vetëm për komunën e Istogut, ka arritur të nxjerr fondin prej 650 000 euro për infrastrukturën e komunitetit tonë.

- Ndryshimet e paralajmëruara nga partia e egjiptianëve!!! Çka mund të ndryshohet këtu? Të gjithë ju që thoni se ndryshimet po vijnë, ju po besoni se keni me largu Xhevdetin nga Parlamenti dhe pastaj gjithçka do të rregullohet. Nëse kjo interpretohet si ndryshim atëherë OK. Duhet të dimë se:

- si do t'i qasen fenomenit egjiptian-ashkali, a do të vazhdojnë me fiskulturat që i patëm në dy vitet e kaluar? Si keni me i bind ashkalitë se problemi jonë nuk zgjidhet me kanar?

-si do t'i qasen pretendimeve të vazhdueshme të lobeve rome për të na grumbulluar në thesin rom, a do të vazhdohet me ankesa se jemi kundër strategjisë, apo do t'i dëgjojnë të rinjtë e lënë anash të shoqërisë civile që 'hanë bukë' nga fondet RAE?

-si do të shkollohemi më shumë? Vetëm mos e thuani se kemi me kriju lehtësira për regjistrim, ose kemi me iu siguru bursa. Tregoni një plan se si me i punësu ata që shkollohen?

-si me zhdruk varfërinë ekstreme, e pranishëm më së shumti te elektorati jonë.

-çka mund të tregoj partia e egjiptianëve lidhur me paragjykimet dhe stereotipat ndaj neve, diskriminimin e pa drejtësitë tjera?

-çka duhet bërë për vetëdijesimin e masës lidhur me përkatësinë e tyre etnike, mungesën e ndjenjave nacionale? Këto, dhe shumë çështje tjera, do të duhej të behën publike se si do të trajtohen ndryshe nga IRDK. Sigurisht se Xhevdeti nuk është i pa zëvendësueshëm, por largimi i Xhevdetit nuk bënë mrekulli.

Unë jam pajtuar se menaxhimi i punëve në parti do të duhej të ishte më i mirë. Por edhe fakti se në Kuvendin zgjedhor kryetari Xhevdet Neziraj është zgjedhur pa konkurrent, nuk është i pa rëndësishëm. Bile unë isha propozuar si kandidat, por nuk e pranova kandidaturën. Askush nuk dëshironte me qa kryt me udhëheqje të partisë.

Unë gjithmonë kam pasur konsideratë për ata që dëshironin që të ketë ndryshime në menaxhimin e punëve në IRDK. Unë gjithmonë jam takuar me ata që dëshironin dinamizimin e punëve në IRDK. I kam dëgjuar idetë dhe i kam mbështet. Kjo kishte treguar edhe rezultate brenda IRDK-së. Mua filluan të më konsiderojnë viktimë e IRDK-së për shkak se humba në zgjedhjet e fundit dhe dhashë dorëheqje nga kryetari i degës. Unë nuk lakmova të behëm deputet, edhe pse me thanë se unë e meritoj. Ashtu siç deklarova kur dhashë dorëheqje nga kryetari i degës, unë do të kontribuoj në Kryesinë e IRDK-së pasi që ka vend për të kontribuar.

Ne të gjithë nuk mund të jemi deputet. Me siguri të madhe do të jetë një deputet nga partitë tona. Unë këto ditë do të tregoj se çka ka bërë IRDK gjatë këtyre viteve, për shkak se ka plotë të mira që IRDK bëri. Do të bëjë përpjekje që konkurrenca për deputet në mes rivalëve politik të mos krijon hendek të madh te populli. Populli ashtu e ka një perceptim se ndarjet janë bërë për 'karriga'.

Në këto rrethana, është një moment i pakthyeshem për karrierën politike të kryetarit të PE. Që në start të mos tregohet si Xhevdeti, por të jep shembull që si kryetar i PE të mos pranoj të jetë bartës i listës, por këtë t'ia besoj një djali të ri apo një vajze të re nga Gjakova apo Fushë Kosova.



Është ndarë nga jeta Imer Alijaj

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, për të kujtuar jetën dhe veprën e Imer Alijaj, është mbajtur një mbledhje komemorative. Në këtë komemoracion kanë fol kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj, Kryesuesi i Asamblesë Komunale të Pejës Islam Husaj, ndërsa kanë marrë pjesë familjar, shokë, miq, koleg partiak nga gjithë Kosova dhe qytetarë nga Peja dhe qytete tjera. Në këtë tubim lamtumirës ndër të tjera u theksua.

Sot jemi mbledhur këtu për një ngjarje që asnjëri nuk e ka dashur që të ndodh, jemi mbledhur këtu për të ndarë dhembjen në mes veti, dhembje që na shkaktuar ndarja nga jeta e Imer Alisë.

Të gjithë ne që e kemi njohur Imer Alinë, të gjithë ne e njohëm Imerin me virtyte të larta, njeri i thjeshtë, njeri që e donte shumë familjen e tij, i donte shokët e tij, e donte shumë popullin e tij.

Ne Imerin e njohëm si ekspert i cili ishte diplomuar në Universitetin e Prishtinës si inxhinier i makinerisë, e njohëm si veprimtar të lëvizjes paqësore të viteve të '90, si themelues i Shoqatës "Shqiptaro-Egjiptiane", si themelues i IRDK-së, si asambleist i Kuvendit Komunal të Pejës, si anëtar i Kryesisë së IRDK-së.

Imeri, për shkak të karakterit të tij, nuk qëndroi indiferent ndaj ngjarjeve që na kanë përcjellë neper periudha të ndryshme. Ai e dha kontributin e tij në LDK gjatë viteve të '90 duke qenë aktiv në strukturat e ndërtruara të asaj kohe. Në vitin 1999 me guximin e tij doli në mbrojtje të të

drejtave lirive të popullit të tij duke qenë themelues i Shoqatës "Shqiptaro-Egjiptiane". Imeri me vizionin e tij ndërtoi koncepte të qarta programore në IRDK duke e trasuar rrugën e Egjiptianëve të Kosovës në integrim në institucione të Kosovës, në promovimin e identitetit kombëtar dhe në avancimin e pozitës së tyre në shoqërinë e Kosovës.

Imeri na duhej neve të gjithëve, i duhej familjes, miqve, e në veçanti IRDK-së. Imeri u nda nga jeta në moshën kur ai mund të jepte nga vetja e tij shumëçka. Atë e goditi një sëmundje e rëndë dhe e mori me vete në amshim.

Sot, të gjithë ne e ndiejmë mungesën e Imerit, do të ndiejmë edhe në të ardhmen dhe vështirë do të kemi pa Imerin.

Veprën e Imerit do ta kujtojmë ne dhe brezat pas neve. Sot po ndahemi nga Imeri me dhembje që ai nuk do të jetë në mesin tonë, ndahemi me krenari për veprën e tij.

Imerin do të kujtojmë si njeri të urtë, si intelektual i komunës së Pejës, si veprimtar i shquar që vendosi bazat e strukturave të organizuara të Egjiptianëve të Kosovës, si ekspert e afarist i suksesshëm.

Lavdi jetës dhe veprës së Imer Alisë.

Ngushllimet e dërguara pas humbjes së Imer Alijaj

E nderuara familje Alijaj, anëtarë të Kryesisë së IRDK-së-Kosovë, bashkombas te nderuar. Me rastin e ndërrim jete te veprimtarit , themelues te subjektit politik IRDK-se-Kosove, pjesëmarrës i shumë aktivitetesh qe konkretizuan suksese, ushtrues i detyrave kyçe qe e ngritën ne pedestal te lart zt Imer Alijaj, ju shprehim ngushëllime me te sinqerta. Kuptohet ne përpiqemi qe për se afërmi qe përmes një letre ti shprehim gjitha ato fjale qe e pasqyrojnë intelektin dhe maturin e tij qe duhet te jete udhëzimit për brezat ne vijim. Familja e ngushtë dhe gjere, koleget, elita intelektuale dhe gjithë komuniteti ynë, fizikisht nuk do ta ketë afër te ndjerin I.Alijaj, por vepra dhe shëmbëlltyra e tij gjithmonë mbesin ne mesin tone. Kryesia e subjektit politik IRDK-se-Kosove, ne krye me zt Xh.Neziraj, nga mesi i tyre humben një punëtor, aktivist, keshillues ne shume sfera jetik , dhe i matur ne zbatim pune gjithmonë qe ju është besu, njëkohësisht ju shprehim ngushëllime te sinqerta. Ne kryesia IRDK-se-dega Gjermani dhe gjithë komuniteti ynë ne Diasporë gjithmonë do ta kujtojmë te ndjerin I.Alijaj ku kemi mësuar nga veprimtaria e tij. Lavdi vepra e tij Kryesia IRDK-se-dega Gjermani .

Kryetari i degës së IRDK-së në Gjermani: Muhamet Salih

E nderuara familja Alijaj Lajmin për ndërrim jetë të kolegut tonë:Ymer Alijaj e morëm me hidhërim të thellë, dhe ishte fare i papritur. Në emrin tim personal, dhe LEK-ut, në Zvicër, pranoni ngushëllimet më të sinqerta për Aktivistin tonë të madhë i cili ka dhënë kontribut të veçantë për ngritjen e vetëdisimit tonë Kombëtar. Njerëzit e dijes dhe të çështjes sonë Kombëtare siç ishte i ndjeri Ymer Alijaj nuk vdesin kurrë, por vetëm e ndrojnë formën e jetesës së tyre, andaj ju familje e të ndjerit dhe Parti e IRDK-së ,e të gjithë të tjerët, përpiqeni që dhembjen ta mundeni me krenari, për ketë burrë të madhë të Kombit.

Ngushëllimet i shprehu : Daut Luboja

Ngushtullime shume te thellta per Imerin! Ishte nje partiot per kazuen tone shume i madh! Levizja Egjiptjane ne Ballkan dhe Kosove humbi nje individue historike te madhe dhe Imer Alijaj do te mbetet per zhdo here ne memorin kolektive ne komunitetit tone!

Rubin Zemon

E nderuara Familja Alijaj, Të nderuar pjestarë të popullitë Egjiptianë Lajmi mbi ndarjen nga jeta e babës, bashkëshortit, vllaut dhe bashkëveprimtarit të Juaj na preku thellë në zemër. Duke e ditur mirë vlerën e të ndjerit kushtuar lëvizjes sonë kombëtare, i cili përveq se ishte intelektual, ai tregoi edhe patriotizmin e tijë ku në kohën më të duhur u kyq në shërbim të popullit duke iu bashkamgjitur lëvizjes sonë kombëtare Egjiptiane. Ishte njeri i matur ku me fjalët e tijë dinte të këshillonte dhe vepronte duke bërë thirrje vëllazërore në dobi të kombëtare. Vdejka e të ndjerit la zbrazëti në mesin tonë, por gjithmonë me vepra të mira duke lënë gjurë të thella në kujtimet tona. Pra këtë Veprimtarë ne nuk do ta vajtojmë, por do ti këndojmë lavdi. Allahu e shpërbleftë me xhenet, e Familjes së tijë durimin ia shtoftë.

Ngushllime nga: Qerim Abazi dhe Ekrem Abazi

Se pari desha te shpreh ngushellimet e mia me te sinqerta familjes te te ndjerit ALIJAJ. Nuk pata fatin ta njoh nga afer, por nepermjet miqve dhe shokeve te tij, dhe veprimtarise se pa lodhur ne sherbim te ceshtjes egjiptiane, AI la mbrapa vepren e gjalle te pavdeksise perkushtimin deri ne momentet e fundit te jetes. Mungesa e te ndjerit ne mesin e shokeve te nje ideali, do te ndjehet per shume koh. Familja pa dyshim humbi njeriun me te shtrenjte , komuniteti egjiptian njeriun e thjeshte dhe te dashur. IPA HARRUAR KUJTIMI I TIJ !

Naim Jonuzi

Familja e nderuar ALIJAJ pranoni ngushllimet e mija te sinqerta.Humbja e antarit se familjes se juaj eshte edhe humbje e entarit te IRDK se dhe e tere komunitetit tone egjiptjane.Prandaj te gjithë ne pjestare te komuniteti egjiptijane jemi pran jushe me dhimbjen qe keni. Allahu e shperbleft me gjeonet

Agim Ramadani

Përshendetje Familja Alijaj,shprehi ngushëllimet e mija nga mbrendia e zemrës,po ashtu edhe për shokët ,kolegët ,bashkëpunëtorët e tij. Lus Zotin e madhëruar që të ndjerin ta e shpërblej me xhenet inshaAllah,ndërsa familjarëve Allahu të i dhuroj durim.AMIN.

Muharrem Asllani

Qe ti pranon ngushllimet më te thella Familja Alijaj nga nga mbar LEK-u dega Tiqino CH.

Luan Murati



Përkujtohet jeta dhe vepra e Mujë Qakollit

Në 5 vjetorin e vdekjes së veprimtarit Mujë Qakolli, Kryesia e IRDK-së, me datën 07.01.2014, në bashkëpunim me familjen Qakolli, kanë organizuar një tubim përkujtimor për jetën dhe veprën e Mujë Qakollit. Kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj theksoi se veprimtaria e jonë sot është vazhdimësi e veprimtarisë së pishtarëve të parë të komunitetit Egjiptian në Kosovë nder të cilët ishte edhe veprimtari ynë Mujë Qakolli. Mujë Qakolli bashkë me shokët e tij Ibish Bajrami, Elez Krasniqi, Zymer Krasniqi, Gani Seferaj, Mustafë Myrtaj dhe shokë tjerë nga treva tjera filluan publikisht punën për çështjen e komunitetit tonë me qëllim më të mirë për popullin e tyre dhe falë punës së tyre sot jemi edhe të organizuar dhe jemi pjesë e institucioneve të Kosovës theksoi Xhevdet Neziraj. Ne me këta pishtar të çështjes së Egjiptianëve krenohemi dhe gjithmonë do t'i përkujtojmë do të themelojmë fonde që mbajnë emrat e tyre, do të themelojmë çmime

me emrat do të titullojmë rrugë dhe sheshe me emrat e tyre.

Beslim Hoti para të pranishmeve theksoi se të marrësh pjesë në një përkujtim për Mujë Qakollin dhe të mos thuash disa fjalë për Mujën nuk është e përbalueshme për mua. Ai revokoi shumë kujtime nga takimet dhe bisedat që kishta pas me të ndjerin Mujë Qakolli gjatë qëndrimit në Gjermani. Beslim Hoti ndër të tjera theksoi momente nga takimet që kishte pas me Mujën, ku për shkak të dredhivë që i kishin bërë Mujës shokët e tij të idealit të cilët pas vitit 1999 ishin rreshtuar në kampin e ashkalive ata ia bënë gjendjen më të vështirë Mujës se sa edhe vet sëmundja e tij theksoi Hoti. Takimi përkujtimor u përmbyll me fjalën e djalit të Mujë Qakollit i cili në emër të familjes i falënderoi IRDK-në dhe të gjithë të pranishmit në këtë tubim përkujtimor.



Takim me delegacionin e degës së IRDK në Gjermani

Me datën 23.03.2014 në Gjakovë, një delegacion i degës së IRDK-së në Gjermani është pritur nga kryetari i IRDK-së me bashkëpunëtorët e tij.

Delegacioni i degës së IRDK-së në Gjermani në përbërje prej Shemsi Kopilit, Qamil Deliu dhe Naser Kongjelit, është informuar nga ana e kryetarit të IRDK-së Xhevdet Neziraj lidhur me zhvillimet e fundit në IRDK dhe situatën e komunitetit Egjiptian në Kosovë. Kryetari Neziraj ka theksuar se rezultati i zgjedhjeve lokale nuk ishte në favor të IRDK-së, për faktin se kemi humbur përfaqësimin në disa komuna. Duke folur për rezultatin e zgjedhjeve ai theksoi se numri i votave nuk ishte më i vogël se sa numri i votave nga zgjedhjet e kaluara por në disa komuna kishte ndryshuar numri i vendeve në Kuvendet komunale dhe në disa komuna kishim numër të madh të partive që fituan nga një vend në asambltetë komunale. Duke folur rreth krijimit të një partie tjetër të komunitetit egjiptian, kryetari i IRDK-së theksoi se kjo është bërë nga individ të caktuar që ishin për vite të tera në IRDK por që nuk kontribuan asgjë në këtë parti. Ai theksoi se IRDK është e hapur për kërkesat dhe propozimet e të gjithëve por nuk do të gjuhëzohet kurrë para askujt. Beslim Hoti i falënderoi delegacionin e degës së IRDK-së në Gjermani për kontributin e dhënë në themelimin dhe zhvillimin e IRDK-së. Ai theksoi se po të mos ishin veprimtarët tanë në diasporë vështirë do të kishim që të vepronim qoftë si shoqatë dhe si parti politike. Ai bëri thirrje që diaspora të ndihmojë përsëri Kosovën, qoftë me vizita në Kosovë qoftë me financimin e projekteve të caktuara.

Delegacioni i degës së IRDK-së ka shprehur ngushëllime për humbjen e themeluesit dhe veprimtarit të IRDK-së Imer Alija. Ata theksuan se ne jemi pjesë e IRDK-së dhe politikave të saj që zhvillohen në Kosovë. Shemsi Kopili u interesua për arsyet e identifikimit të Egjiptianëve me RAE, për ndarjen në Rrafshin e Dukagjinit dhe Kosovës dhe për

rezultatit e zgjedhjeve lokale. Qamil Deliu theksoi nevojën e adresimit të kërkesave nga Kryesia e jo nga individët e caktuar, dhe kërkesat të adresohen në formë të projekt propozimeve. Naser Kongjeli njoftoi Kryesinë për riaktivizimin e degës së IRDK-së në Gjermani. Ai theksoi se jemi në përpjekje për themelimin e një fondi nga anëtarësia. Ai përmendi aktivitetet lidhur me mundësitë për bashkim me ashkallitë dhe theksoi nevojën e përhapjes së Egjiptianëve në të gjitha regionet e Kosovës. Si nevojë të veçantë ai theksoi aktivizimin e degës së IRDK-së në Zvicër.

Kryetari i IRDK-së ka theksuar se ndarja regionale është shkaktuar nga fakti i ndarjen në Egjiptian dhe Ashkali, ndërsa sa i përket termit RAE ai theksoi se IRDK nuk ka pranuar të jetë pjesë e strategjisë RAE dhe në Kuvendin e Kosovës janë miratuar rekomandimet për largimin e Egjiptianëve nga kjo strategji. Të gjithë na përkrahen në Kuvend për këtë çështje ndërsa deputeti ashkali Danush Ademi ishte kundër theksoi ai. Shoqëria civile e komunitetit RAE po e mbajnë gjallë këtë strategji, prandaj edhe themeluesit e partisë së re të Egjiptianëve tani do të bëjnë përpjekje që të mbajnë gjallë komunitetin RAE pasi që IRDK arriti të largoi egjiptianët nga kjo strategji, theksoi kryetari Xhevdet Neziraj. Të gjithë themeluesit e partisë së Egjiptianëve janë implementues të strategjisë RAE prandaj bëjë thirrje që populli të jetë i kujdesshëm sepse kjo parti angazhohet për shkrirjen e Egjiptianëve në komunitetin RAE, e që në të ardhmen do të jetë vetëm komuniteti Rom, theksoi kryetari Xhevdet Neziraj.

Në pritje të delegacionit nga Gjermani morën pjesë Beslim Hoti, Ramadan Hasani, Gazmend Dervishi, Fazli Stollaj, Bedri Mustafa, dhe Elbert Krasniqi.

Në takim u pajtuan që në të ardhmen të shkëmbehen informacionet në mes Kryesisë së IRDK-së dhe degës së IRDK-së në Gjermani sikurse me të gjitha degët tjera.



Emin Sefaj është zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i IRDK-së

Me datën 15.03.2014, në Pejë është mbajtur mbledhja e Këshillit Drejtues të IRDK-së. Në këtë mbledhje është diskutuar për: zhvillimet e fundit në IRDK, plani i veprimit për vitin 2014, përgatitja për zgjedhjet nacionale, diskutimi lidhur me letrën nga LEK-Ch dhe Kleopatra nga Gjermania dhe çështje tjera.

Nga zhvillimet e fundit në IRDK, debati është përqendruar në dorëheqjen e Sekretarit të IRDK-së Veton Berisha, motivet e dorëheqjes dhe mbledhja e nënshkrimeve nga ana e tij për formimin e një partie tjetër politike. Shumica e anëtareve të Këshillit Drejtues kanë theksuar se mënyra e parashtrimit të kërkesave të ish sekretarit, ose të plotësohen ose të largohet nga IRDK, nuk ka qenë pranueshme. Gjithashtu disa nga anëtarët e Këshillit Drejtues vlerësuan se formimi i një partie të re nuk do të jetë në dobi të popullit pasi që kemi nevojë që energjinë tonë të grumbullojmë brenda IRDK-së. Pati edhe mendime se konkurrenca në politikë nuk do të jetë e dëmshme por do të sjellë kualitet. Në fund të debatit lidhur me këtë çështje, me shumicë votash, Emin Sefaj, njëri prej themeluesve të IRDK-së, është zgjedhur për Sekretar të Përgjithshëm.

Elbert Krasniqi ka prezantuar Planin e Veprimit të IRDK-së për vitin 2014. Ai prezantoi objektivat dhe aktivitetet për secilën objektiv dhe bëri thirrje te anëtarët e Këshillit Drejtues që të kontribuojnë në pasurimin e këtij dokumenti.

Lidhur me përgatitjet për zgjedhjet 2014, kryetari i IRDK-së bëri thirrje te kryetarët e degëve që të mobilizohen dhe të organizojnë takime më të shpeshta me popullatën në vendbanimet ku është koncentruar komuniteti. Ai theksoi se IRDK në këtë zgjedhje do të jetë fitues ashtu sikur herave tjera pa marrë parasysh çdo herë në zgjedhjet parlamentare do të kemi individ që e lakmojnë pozitën e deputetit, ndërsa ata nuk do të dëgjohen pas disfatës që do të marrin nga populli.

Shkresa e dërguar nga LEK në Zvicërr dhe Kleopatra nga Gjermania është shqyrtuar nga ana e anëtareve të Këshillit Drejtues. Të gjitha çështjet e trajtuara nga kjo shkresë ishin trajtuar në pikën e parë - zhvillimet e fundit dhe përmes një shkrese do t'ju kthehet një përgjigje, a cila do të jetë përmbledhje e diskutimeve të anëtareve të Këshillit Drejtues.

Në fund janë paraqitur edhe disa çështje tjera nga ana e anëtareve të Këshillit Drejtues.



Të rinjtë e Istogut në Forumin Rinor të IRDK-së

Me datën 22.03.2014, në Istog, të rinjtë e komunitetit Egjiptian të kësaj komuna kanë themeluar Forumin Rinor të IRDK-së në degën e Istogut. Në këtë takim të të rinjve ka marrë pjesë edhe kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj, kryetari i degës së IRDK-së në Istog Imer Zikolli, dhe anëtari i Kryesisë së IRDK-së Fazli Stollaj. Duke i inkurajuar të rinjtë e komunitetit Egjiptian, kryetari i IRDK-së theksoi se tani në Kosovë janë krijuar rrethana të reja, dhe në të ardhmen do të kërkohen vlerat, prandaj ne jemi të sigurt se Egjiptianët e Kosovës kanë vlera të çmuara dhe këto vlera i gjejmë te rinia e jonë. Ai theksoi se do të mbështesim rininë tonë aty ku kemi mundësi në mënyrë që të mundësohet shprehja e talentit, shkollimit por edhe punësimit pas përfundimit të shkollimit.

Të rinjtë e Istogut potencuan mungesën e ambienteve sportive dhe përkrahjes në aktivitetet sportive. Ata u pajtuan që vet të organizohen dhe të bëjnë përpjekje për zhvillimin e aktivitetëve rinore. Ata vendosën që në Forumin Rinor të IRDK-së në Istog

të udhëhiqet nga Bekim Ferizaj, student i Fakultetit Ekonomik, për nënkryetar është zgjedhur Rexhep Sylaj, një sportist i talentuar në komunën e Istogut dhe Sekretar Bujar Dautaj gjithashtu sportist i talentuar.





Sqarim për Opinionin Publik

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, për arsye të informimit të drejt të simpatizantëve dhe Egjiptianeve në Kosovë sqaron se largimi i Sekretarit të IRDK-së z.Veton Berisha është veprim i ndërmarrë për interesa të tij personale dhe si i tillë adresa e përgjegjësive mbetet tek z.Berisha.

IRDK, fuqishëm mbetet e fokusuar në rrespektim të idealeve themeluese dhe rrespektimin e organeve të Partisë. Demokratizimi i më tejshëm i IRDK-së është proces dinamik dhe jo veprimi mbi baza të dëshirave të profitoreve dhe agjenteve pasues të strategjive keqbërëse për Komunitetin dhe Identitetin Egjiptian në Kosovë.

Në takimin e Kryesisë të datës 02 Mars 2014, nga ish Sekretari i Partisë është parashtruar një "Kërkesë" qëllimi i së cilës ishte të shërbente si ALIBI për largimin e tij nga IRDK për qëllime të tija personale dhe aspak parimore dhe zhvillimore të partisë, përfaqësuese legjitime të Komunitetit Egjiptian në Kosovë.

E ashtu quajtura Kërkesë e Z. Berishes vjen në momentin kur Vendi gjendet në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ku nga momenti i shpërbërjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës në afat 45 ditë do të organizohen zgjedhjet nacionale.

IRDK, vlerëson se do të duhej së paku një afat kohore prej 6 muaj për organizimin e zgjedhjeve në kuvendet e degëve dhe atë të nivelit qendror, që të jenë demokratike, të mirëfillta, legjitime dhe gjithëpërfshirëse. Si rrjedhojë e kësaj, për tejkalimin e situatës së dalë nga zgjedhjet e fundit lokale, plani i veprimit 2014 parashih aksione konkrete për menaxhimin e kësaj situatë.

Aventurat e kuvendeve të parakohshme do t'i shërbejë vetëm Z, Berishes, që energjia dhe aktiviteti ynë të fokusohet në Kuvend të partisë që profitet dhe agjentët e strategjive keqbërëse për Egjiptianet, të kenë me të lehtë garën për në Kuvendin e Kosovës.

z.Berisha dhe persona të tjerë nga Shoqëria civile (të cilët tani kanë krizë për të siguruar një vend pune), në emër të Kërkesës dëshiron të instrumentalizoj me persona brenda për brenda IRDK-se, si dhe të sjell përçarje në mesin e votuesve besnik të partisë.

Siç edhe e dini, fondeve Keqbërëse për egjiptianët po ju vjen fundi dhe pas Kalimit të Rekomandimeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku IRDK suksesshëm arriti që në Organin më të lart Politik të ndikoj për largimin e Egjiptianëve nga kjo strategji.

IRDK, i kupton apetitet e këtyre personave që gjatë gjithë mandatit heshtin dhe pasivizohen dhe në prag të zgjedhjeve të prira nga interesa individuale dhe material vërsulen që në emër të "Reformës" të ngrisin zërin, por kjo zgjat shumë pak dhe me përfundimin e zgjedhjeve zhduket.

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, përfaqësues legjitime e komunitetit Egjiptian në Kosovë, mbetet e përkushtuar në avancimin e të drejtave të komunitetit dhe ngritjen e mirëqenies së tyre. Inkuadrimi i kuadrove të reja në IRDK është objektiv Strategjik dhe si e tillë në mbesim të hapur për të gjithë që dëshirojnë të kontribuojnë për një shoqëri demokratike si dhe për mirëqenien socio-ekonomike të komunitetit.



Miratohet Plani i Veprimit për vitin 2014

me datën 02.03.2014, në Pejë është mbajtur mbledhja e Kryesisë së IRDK-së. Në këtë mbledhje është diskutuar lidhur me përgatitjen për zgjedhje, është paraqitur plani i veprimit për këtë vit, është propozua dhe miratuar buxheti për vitin 2014.

Kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj, duke iu referuar mundësisë së mbajtjes së shpejtë të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, theksoi se ne duhet të punojmë shumë në mënyrë që të jemi të përgatitur për këto zgjedhje. Ai bëri thirrje për unitet dhe vëmendje të veçantë në mënyrë që parti të caktuara dëshirojnë të fusin përçarje brenda nesh. Ai u shpreh i sigurt se IRDK si gardian i identitetit Egjiptian në Kosovë prapë do të triumfoi dhe komuniteti Egjiptian i Kosovës do të jetë i përfaqësuar në mënyrë të denjë në institucionet e Kosovës. Plani i veprimit të IRDK-së për këtë vit e prezantoi Elbert Krasniqi. Ai theksoi se Plani i veprimit si objektiv gjenerale ka avancimin e kauzës së Egjiptianëve, faktorizimin në vendet ku ata përbejnë pjesë dermuese të popullatës, promovimin e identitetit, kulturës dhe mbrojtjen e interesave politike. Ndërsa objektiva specifike përmendi: Fuqizimin e strukturave të partisë, avancimin e raporteve me votuesit, avancimin dhe promovimin e identitetit të Egjiptianëve në Ballkan, krijimi i platformës unike të veprimit dhe përfaqësimin me simbole dhe emërtim të unifikuar. si dhe krijimin e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë zhvillimore 2020.

Kryesia e IRDK-së miratoi buxhetin për vitin 2014. Gjithashtu është prezantuar projekt propozimi për miratimin e simboleve etnike për Egjiptianët e Ballkanit dhe për unifikimin e emërtimit për të gjithë Egjiptianët e Ballkanit. Projekt propozimi parasheh zhvillimin e debatit nga Egjiptianët e Ballkanit lidhur me simbolet dhe emërtimin unik në një Forum që do të mbahej me 23 dhe 24 Qershor të këtij viti. Ky Forum do t'i rekomandonte Unionit të Egjiptianëve të Ballkanit për simbolet dhe unifikimin e emërtimit. Sekretari i Përgjithshëm i IRDK-së Veton Berisha ka dhënë dorëheqje nga ky post për shkak se Kryesia e IRDK-së nuk e ka miratuar kërkesat e tij që kishin të bëjnë me bartësin e listës, mbajtjen e kuvendeve zgjedhore nëpër degë, vendosjen e emrit nacional në subjektin tonë politik dhe publikimin e qarkullimit bankar të xhirollogarisë së IRDK-së prej vitit 2004. Lidhur me kërkesën e parë që ishte që bartës i listës në zgjedhjet e ardhshme të mos jetë kryetari i IRDK-së por Fazli Stollaj, anëtarët e kryesisë theksuan se në kohë të përshtatshme dhe sipas statutit të IRDK-së Këshilli Drejtues i IRDK-së do të miratojë listën zgjedhore. Gjithashtu u theksua se menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve nacionale do të mbahen zgjedhjet në parti dhe Kuvendi do të vendos për propozimin lidhur me emrin e IRDK-së. Ndërsa lidhur me publikimin e xhirollogarisë së IRDK-së, kryetari Xhevdet Neziraj theksoi se në çdo Kuvend është miratuar raporti financiar dhe në Kuvendin e ardhëm do të paraqitet raporti financiar për periudhën e fundit.

Arrihet pajtueshmëri në Gjermani për përafrim në mes Egjiptianëve dhe Ashkalive

Me datën: 09.02.2014

Në: Frankenthal

Në takimin e inicuar nga dega e IRDK-së dhe dega e PDAK-së në Gjermani, dhe me kontribut të veçantë të Shemsedin Kopilit, ku morën pjesë: Muhamet Salih, Ramiz Zizaku, Afrim Kryeziu, Naser Kongjeli, Shemsedin Kopili, Gani Sejdiu, Sherif Jupi, Nexhdet Karaxha, Muharrem Prizreni, Hilmi Bugari, Milazim Alijaj, Murtez Krasniqi, Xhevdet Gavrani, Nuhi Shabani, Ekrem Abazi, Nehat Shabani, Afrim Sejdiu, në një rën anë dhe: Rrahmon Asllani, Sefer Krasniqi, Enver Rexhepi, Osmon Berisha, Shemsi Berisha, Shyrei Mehmeti, Riza Mehmeti, Arben Rexhepi, Bajram Haziri, Ernes Rexhepi, Agron Rexhepi, Enver Rexhepi, në anën tjetër, në një atmosferë relaksuese është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit për interesa të përbashkëta të komunitetit Egjiptian e Ashkali, dhe pas bisedave vëllazërore arritëm në këto:

Konkluzione

I. Ndarja e popullit tonë në Egjiptian dhe Ashkali nuk është aspak reale, por është shumë e dëmshme sepse për gjeneratat e ardhshme kjo ndarje mund të shndërrohet në realitet.

II. Të gjitha formacionet e organizuara politike e jo politike dhe individët nga ana e Egjiptianëve dhe Ashkalive, në Kosovë e në diasporë, duhet të kontribuojnë për minimizimin e ndasive dhe afirmimin e vlerave të përbashkëta që i kemi kultivuar me shekuj.

III. Të gjithë ne duhet të fillojmë menjëherë të bashkëpunojmë në të gjitha fushat ku i shprehim vlerat tona të përbashkëta me qëllimin final që në të ardhmen të mos kemi asnjë dallim.

IV. Përafrimin tonë do të lehtësojmë përmes formimit të Këshillit të përbashkët i cili do të koordinohet nga Ramiz Zizaku dhe me përbërje nga: Muhamet Salih, Afrim Kryeziu, Ekrem Abazi, Milazim Alija, Xhevdet Gavrani, Naser Kongjeli, në një rën anë dhe nga: Rrahmon Asllani, Enver Rexhepi, Sefer Krasniqi, Shemsedin Berisha, Sefedin Rexhepi, Bajram Haziri, në anën tjetër, i cili do t'i paraprijë bashkëpunimit dhe përmes bisedimeve do t'i eliminojmë pengesat që mund të paraqiten.

V. Në Kosovë, pozitat politike të rezervuara, nuk duhet të shërbejnë për vazhdimin e thellimit të ndarjes tonë por duhet të shërbejnë për përafrim dhe për bashkimin e forcave në realizimin e interesave të popullit.

VI. Populli i jonë i shpërndarë në diasporë, i inkurajuar nga nismat e juaja në Kosovë për përafrim, ju fton të gjithëve, e në veçanti përfaqësuesit tanë politik në Kuvendin e Kosovës, që të kursejnë veten nga lakmia për pozitat e rezervuara, dhe të krijojnë menjëherë mekanizmat për bashkëpunim dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve, si kusht për t'i merituar ulëset në Parlament.

Kryetari i degës së IRDK-së në Gjermani: Muhamet Salih

Kryetari i degës së PDAK-së në Gjermani: Rrahmon Asllani



Imer Alijaj

Me: 29.10.2010

Po e shoh të arsyeshme që pas gati dhjet viteve duhet ta komentojmë-sqarojmë gjegjësisht shtjellojmë emrin e partisë sonë te vetme në historinë e popullit Egjiptian në këtë Regjion.

Pas iniciativës ndoshta?, të pare të Zotri Sali Murati, pastaj iniciativa e dytë apo tjetër e disa bashkëveprimtareve të tij që nuk po i cekim, pastaj iniciativa e viteve nëntëdhjeta, pastaj iniciativa e pas luftës me shoqatën Shqiptaro Egjiptiane e Kosovës, pastaj shumë shoqata tjera lokale-Komunale, nga disa(pakë) njerëz u ndërmor edhe një iniciativë më e re por demokratike që veprimtarinë e saj do e zhvillonte kryesisht në Kosovë. Që kjo iniciativë të jetë më kontribuuese duhej të regjistrohej si parti politike nga se në Institucionet e Kosovës nuk kishte mundësi tjetër të përfaqësimit të popullit Egjiptian. Në statutin e IRDK-së (për ata që nuk kanë pasur rast ta lexojnë) shkruan,citoi:

NENI 1

Partia politike, emërtimi dhe simbolet
1.1. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është parti politike e egjiptianeve të Kosovës dhe qytetarëve tjerë të cilët pranojnë programin dhe statutin e saj. Qëllimet dhe parimet e IRDK-së janë përcaktuar në programin politik.

1.2. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është parti e qendrës me orientim socialdemokrat. Veprimtaria e saj është e përqendruar në mirëqenien sociale, ekonomike, arsimore, kulturore të qytetareve të Kosovës dhe në veçanti promovimin e identitetit etnik, vlerave kulturore e historike dhe avancimin e pozitës së egjiptianeve të Kosovës.

1.3. Emri i partisë është: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, me shkurtesën : IRDK

Shtjellim i emrit IRDK

Po e publikojmë shkrimin e Imer Alijaj që e shkroi dhe e publikoi në ueb faqën e IRDK-së me datën 20.10.2010.

Andaj IRDK është parti e Egjiptianëve të Kosovë dhe askush në tërë botën nuk e njeh si parti të ndonjë komuniteti tjetër. Arsyetimi i disa njerëzve që të kemi parti me emër nacional, gjëja që do të ketë më sukses nuk qëndron dhe e fshehin mos angazhimin dhe mos kontributin e tyre ndaj kësaj partie, apo kontributi i tyre ka qenë me përfitime personale.

Ishte IRDK-ja, ajo që popullin tonë e futi në Kushtetutën e Kosovës (që asnjë ish Republika Jugosllave, Shqipëria apo vende tjera nuk e kanë ende), që në fillimin e veprimtarisë së saj punësoi Egjiptian në policinë e Kosovës, pastaj në Dogana, rezervoi vende për student në Universitet, shkolla të mesme, ndërtoi, rindërtoi etj. Sipas angazhimeve tona përfaqësohemi në të gjitha institucionet e Kosovës dhe të Komunave.

Të gjitha këto që janë shumë pakë nga pretendimet tona janë arrit me emrin IRDK, andaj IRDK-ja duhet të ruhet, të respektohet nga se është parti e parë dhe historike e jona.

Në të gjitha partitë e botës kryesin e cakton elektorati, mund të deklaroi lirshëm që nga diaspora kurrë nuk ka ardhur as një votë e vetme edhe pse e kanë pasur atë mundësi që të kontribojnë dhe të ndikojnë në përcaktimin e kryesisë. Në kryesi të ngushtë të IRDK-së ishte edhe zotëri Bislim Hoti, nëpër mes të IRDK-së (Egjiptiane) ka arritur të behët nënkryetar i parlamentit të Kosovës, tani nënkryetar i Kuvendit Komunal në Gjakovë andaj iu lutëm nuk është fajtorë emri i partisë por mos angazhimi i jonë në parti.

Nga se isha nder themeluesit dhe kontribues që partia ta kishte këtë emër,„IRDK”, ndjeva obligim moral dhe si kryetar i Forumit Egjiptian të Kosovës ta bëjë këtë shtjellim të vogël.

Iu faleminderit për mirëkuptim

Imer Alijaj,

Kryetar i Forumit Egjiptian të Kosovës



Elbert Krasniqi

Oda dhe Fondi për mbështetjen e subjekteve politike!

Ditëve të fundit ODAT e Egjiptianëve të Kosovës kishin mikpritje të hapura për miq, e të gjithë ata që po vërsulen në to, para vetës kanë një detyrë bajagi të vështirë. Tradicionalisht në to janë shtjelluar shumë punë e konteste të popullit, por këto ditë funksioni tradicional i tyre ka pësuar një ndryshim të madh, duke shtjelluar pikë për pikë arsyen e Formimit të Subjekti të ri Politik, siç do t'i lexoni në vijim:

1. Bartës i listës të jetë Fazli Stollaj dhe JO Xhevdet Neziraj?

Përgjigja: Pak a shumë sikur në Kuvendin e Fundit Zgjedhor, kur nga Delegatet e një dege për ta sfiduar Liderin propozojnë si kundër kandidatë po të njëjtin bashkpartiak! Pa pëlqim të tij.

Arsyetim: Ka legjitimitetin e Kuvendit të fundit për Kryetar të Partisë, në listë të hapur në zgjedhjet e fundit nacionale ka marrë më së shumti vota. Nga zgjedhjet e fundit lokale është marr një vendim për bartës të Listës dhe deri në një vendim tjetër do të vlejë e njëjta praktikë.

2. Kuvendet Urgjente në Degët e IRDK-së, JO Kuvend Qendrore?!

Përgjigja: T'i dërgojë në shtëpi Kryetarët aktual, përkrahës të Kryetarit Xhevdet Neziraj, e të sjell Kryetar të ri të cilët do të votojnë pro ndërrimit të praktikës Kryetari-Bartës i Listës.

Arsyetimi: Nuk jeni të pranueshëm në popullatë, i keni humbur zgjedhjet! Fazli Stollaj, nuk pranojë të jetë bartës i listës më herët, ky është çelësi ideal për Vendin e Rezervuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e pastaj nuk bëhet vonë për Kuvend në Nivel Qendror që të zyrtarizohem Kryetar.

3. Ndërrimi i Emrit dhe pagëzimi me Emër Nacional!

Përgjigja: Kërkesa i është dërguar Kryetarit dhe Kryesisë së Partisë, ata nuk do ta pranojnë me justifikimin se nuk është në kompetencat e tyre!

Arsyetimi: Kështu, ultimatum i O gjitha kërkesat O IKA, këtu është viza për të fituar simpati e me formu një subjekt të ri.

4. Publikimi i llogarisë Bankare nga 2004!

BINGO! Odave kjo po ju pëlqen, kjo temë po jap material me diskutu. Ashtu ashtu gjitha pikat e tjera të kërkesës nuk po bëjnë përshtypje të madhe!

Në Oda po e dinë që Fazli Stolla nuk ka nevojë për avokat dhe avancimi i tij në IRDK është dhe do të jetë rezultat i kontributit të tij.

Kuvendet Partiake, e kanë kalendarin e tyre zgjedhor, edhe ashtu jemi mësuar me kërkesa për reformim në prag të zgjedhjeve.

Emri Nacional, po ju kujtohet që edhe dikush më parë pat luajtur në të njëjtën Kartë (Letër) dhe nuk pat sukses!

Gjithë andej në fshatra e lagje ku jetojnë Egjiptianët në Kosovë, në ato ODA ku ka arritur Kasneci më informatat për "dorëheqje" pika 4 është me e diskutuara dhe me atraktivja, ku varësisht nga disponimi dhe imagjinat ju tregohet se çka krejt do të mund të bëhej e ndërrohej më këtë buxhet. Sigurisht jo e Vërteta, sigurisht që në asnjë nga këto takime nuk ju tregohet së më Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, në Nenin 8:

Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

Qëllimi i përdorimit të mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Mjetet nga Fondi mund të përdoren për këto qëllime:

1.1. financimi i aktiviteteve të subjekteve politike;

1.2. financimi i degëve të subjekteve politike;

1.3. për shpenzime materiale vjetore të deputetëve dhe punën e Grupeve Parlamentare për aktivitete partiake;

1.4. për shpenzime për zgjedhjet lokale dhe qendrore, dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të subjekteve politike.

E precizon se për çfarë mund të shfrytëzohet Fondi për mbështetjen e subjekteve Politike dhe për çfarë jo! E sigurisht që në këto takime nuk ju tregohet se të gjitha Raportet Financiare Vjetore dhe Raportet e Auditit mund t'i gjejnë online në faqe të KQZ-së (<http://www.kqz-ks.org/sq/raportet-financiare-auditimet>), ku mund të shihet se sa secili Subjekt Politik përfiton nga Fondi dhe ku shkojnë ato mjete.

E drejta në asocim dhe pluralizëm partiak si baza të demokracisë e njohin dhe e pranojnë konkurrencën dhe për vendet e Rezervuara, "alternativa" politike të Egjiptianet do të duhej të shpalesë programin politik, nëse ka, dhe jo të instrumentalizoj më qytetarët e ndershëm.



Fazli Stollaj

Fenomeni Egjiptian - Ashkali nuk zgjidhet me matematikë

Është shumë e rëndësishme kur individ apo grupe të organizuara politike organizojnë takime, për të biseduar për çështjen delikate egjiptian-ashkali në Kosovë. Një takim i organizuar në Gjermani, i inicuar nga dega e IRDK-së dhe PDAK-së në Gjermani, është një nismë e mirë për faktin se në takim morën pjesë numër i konsiderueshëm i veprimtarëve tanë në Gjermani dhe për pajtueshmërinë që ata arritën. Që në fillim duhet theksuar se individët nuk duhet nxituar për të shpërblyer veten me merita për organizim të takimit, ose për të vendosur gjithçka nën kontroll, por duhet demonstruar mençuri për të arritur rezultate. Për fat të keq ne jemi në deficit sa i përket mençurisë e urtësisë. Arsyeja pse shkruaj për këtë çështje është që të ndihmoj në këtë punë, përmes vizionit tim që kam për fenomenin Egjiptian-Ashkali.

Egjiptianët e Ashkalitë, për mua janë i njëjti brum, me disa dallime të aspektit social si reflektim i distancës së regjioneve - Dukagjini dhe Fusha e Kosovës. Tani, në mes Egjiptianëve dhe Ashkalive, ekziston një vijë ndarëse, e krijuar si pasojë e deficitit të mençurisë. Gjatë 15 viteve të kaluara, u trash vija ndarëse në mes popullit, duke u larguar nga njeri tjetri. Do të ishte ideale që vija ndarëse të zhduket duke e zbuluar zgjidhjen ekuacionit të komplikuar Egjiptian - Ashkali. Kjo është e pa besueshme që të ndodh për shkak se ekuacioni nuk ekziston, dhe ata që pretendojnë se e dinë, nuk e dinë matematikën sepse nuk e përdorin hiq operatorin e barazimit (=) në ekuacion. Prandaj në fenomenin Egjiptian - Ashkali nuk duhet kërkuar zgjidhje matematikore. Në këtë rast duhet ndërruar qëndrimet për njeri tjetrin. Qëndrimet e ndryshuara duhet të na qojnë në drejtim të ngushtimit të vijës ndarëse - ofrimin me njeri tjetrin. Në zgjidhjen e fenomenit Egjiptian - Ashkali, nuk është e pa rëndësishme të dihen se cilat qëndrime duhet ndryshuar. Këtë e dinë shumë kush, por unë po i them disa. P.sh. qëndrimi:

- Egjiptianët e Ashkalitë nuk kanë asgjë të përbashkët - të transformohet në
- Ne Egjiptianët e Ashkalitë jemi një ose qëndrimi:
- Egjiptianët kanë prejardhjen nga Egjipti, e Ashkalitë nga Persia - të transformohet në
- Ne Egjiptianët e Ashkalitë kemi prejardhje të njëjtë etnike, dhe pajtohemi që etnogjeneza jonë të hulumtohet në mënyrë shkencore nga shkencëtarët ose qëndrimi:
- Ne po mbetemi Egjiptian e ju Ashkali - të transformohet në
- Ne s'po humbin asnjë minutë kohë por po fillojmë të formojmë një ekip të përbashkët futbollit, një grup të përbashkët vallëzimi, një organizatë të përbashkët studentore, një grup të përbashkët për kundërshtimin e apetiteve rome për të na bërë romë, etj. ose qëndrimi:
- Në rast se deklarohemi se jemi një, na rrezikohen vendet e rezervuara - të transformohet në
- Punë e madhe nëse humbin vendet e rezervuara, bëhemi bashkë e i fitojmë vendet me vota ose qëndrimi:
- Ne Egjiptianët jemi intelektual e Ashkalitë janë të pa shkollë - të transformohet në
- Ne kemi shumë pak intelektual, prandaj duhet t'i shkollojmë fëmijët ose qëndrimi:
- Ne Ashkalitë jemi më shumë se Egjiptasit - të transformohet në
- Ne bashkë mund të jemi komuniteti i tretë për nga numri

Këto janë disa prej qëndrimeve të cilat tani m'u kujtuan e të cilat duhet transformuar. Krejt esenca e këtij fenomeni është - krijimi i besimit të ndërsjellë. Deficiti në lidhshmëri në komunitetin tonë është problem i madh në këtë çështje sepse këto të gjitha që po i përmend unë e të tjerët për këtë fenomen i bien se "po çajmë dërrasa".

Unë po dua të besoj për një riaktualizim të kësaj çështje me rastin e takimit në mes degëve të IRDK-së dhe PDAK-së në Gjermani, e falënderoj shumë Ramiz Zizakun që më kontakton vazhdimisht për këtë çështje, dhe jam shumë i sigurt që të gjithë ata që angazhohen pa hile në këtë punë, janë duke punuar drejt sepse këtë punë duhet përfunduar ne vetë. Populli i jonë e meriton të jetoj me dinjitet, edhe popujt tjerë kanë pasur probleme me identitetin e tyre, me historinë e tyre, por i kanë tejkaluar. E kam përshtypjen se ne kemi mbetur të vetmit me identitet të paqëndrueshëm, e si pasojë po e lëmë derën hapur për lobet rome të cilët tregojnë si gjithmonë apetit për të na futur në gëzhhojen rome.

Forumi i Egjiptianëve të Ballkanit

Projekt propozim

Hyrje

Komuniteti Egjiptian në Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mali Zi, Bosnje Hercegovinë, Bullgari, Greqi etj.), i njohur me etnonime të ndryshme si: magjup e ashkali në Kosovë, evgjitë, jevg e magjyp në Shqipëri, majupci në Maqedoni, kovaç në Mal të Zi etj., është një grup etnik autokton në trevat e Ballkanit. Këtë grup etnik në Ballkan, i identifikuar me etnonime të ndryshme, shpesh edhe i ngatërruar me grupe etnike të tjera, veçanërisht me romët, të paktën gjatë shekullit XX, e kishte kapluar harresa etnike.

Shkolla evropiane, e nxitur nga modeli arian i shekullit të XVIII, për grupin etnik me etnonimet që i referohen Egjiptianëve të Ballkanit, kishin bërë paragjykimë duke i trajtuar në literaturë si grupe rome. Faktet historike dhe arkeologjike tregojnë për prezencën e kulturës së Egjiptianëve, qysh para epokës së re, dhe tezat e qëndrueshme shkencore kanë vërtetuar kolonizimin e Ballkanit nga Egjipti Antik qysh në kohën e fillimit të përdorimit të hekurit. Prania e Egjiptianëve në Ballkan ka lenë gjurmë në të gjitha epokat e zhvillimit, dhe për shkak të diskriminimit të vazhdueshëm ndaj Egjiptianëve në Ballkan, për shkak se ky grup etnik u rrethua nga kultura të ndryshme, Egjiptianët e Ballkanit i kishte përfshirë harresa mbi prejardhjen etnike. Edhe pse ky grup i veçantë etnik, në shekullin e XX, e kishte harruar prejardhjen e tij etnike, ata e kishin krijuar identitetin e tyre të veçantë, ndërsa nga popujt tjerë u trajtuan me përbuzje. Për shkak të dominimit të racizmit në trevat e Ballkanit, për shkak të sistemeve të egra jo demokratike, edhe etnonimet e këtij grupi etnik u shndërruan në emërtime përbuzëse. Secili prej etnonimeve për këtë grup etnik mori karakter të përbuzjes së dinjitetit njerëzor, dhe ky karakter i tillë, në masë të madhe, u pranua edhe nga vetë komuniteti. Për këtë arsye, gjatë shekullit të kaluar, kishte familje apo individ të Egjiptianëve të Ballkanit të cilët u identifikuan me grupe etnike tjera, për t'ju shmangur karakterit përbuzës së etnonimeve që i kishin instaluar të tjerët. Kjo dukuri, në masë më të vogël, është e shprehur edhe tani.

Gjatë zhvillimeve historike, intelektual nga Egjiptianët e Ballkanit, kanë lenë gjurmë me veprime të ndryshme që e kanë demonstruar protestë kundër formave të trajtimit jo të drejt nga ana e religjioneve apo pushteteve. Paraqitja publike gjatë shekullit XX ishte në vitin 1990, atëherë kur u shemb sistemi komunist. Me 24 Qershor 1990, në Ohër të Maqedonisë, ishte organizuar Kuvendi i Egjiptianëve të Jugosllavisë që kishte për synim lejimin e deklarimit si Egjiptianë në të gjitha viset e Jugosllavisë. Beteja për legalizim të deklarimit të përkatësisë kombëtare, si Egjiptian, ishte fituar, dhe me 1991 kishim regjistrimin e popullsisë, ku kishte mundësi deklarimi edhe si Egjiptian.

Deklarimi si Egjiptian u përhap nga Maqedonia, në Kosovë, Serbi por edhe në Shqipëri. Për shkak të harresës etnike, prejardhjen nga Egjipti, populli e priti me skepticizëm, për shkak se ishin quajtur me etnonime tjera. Hulumtimet shkencore ishin ato që do të arsyetonin identifikimin si Egjiptian. Fillimisht filloj identifikimi si Egjiptian i Jugosllavisë e pastaj si Egjiptian të Ballkanit apo Ballkano Egjiptian, dhe pas vitit 1999, në Kosovë, si Egjiptian.

Shpërbërja e shtetit Jugosllav, aty ku jetonin edhe Egjiptianët, u përcjell me tensione ndëretnike e që rezultuan edhe me luftëra ndëretnike. Pushteti represiv i Serbisë në Kosovë gjatë viteve '90, ishte i dëmshëm edhe për Egjiptianët e Kosovës, për shkak se nuk kishte sistem demokratik, liria e shprehjes nuk ekzistonte, prandaj edhe Lëvizja e Egjiptianëve të Kosovës nuk ishte në pozitën të mirë. Pas vitit 1999, në Kosovë, duke u gjendur komuniteti në një gjendje shumë të vështirë, individ të caktuar, e më pas edhe grupe të caktuar, duke e shfrytëzuar edhe praninë ndërkombëtare, e deklaruan komunitetin për herë të parë edhe si ashkali, ndërsa lëvizja egjiptiane vazhdoi me struktura te reja. Edhe sot, populli është i ndarë në Kosovë: në Egjiptian dhe ashkali. Ashkalitë u nxituan me shpjegime lidhur me prejardhjen e tyre etnike, lider të tyre me deklarata duke etiketuar Egjiptianët, me nxjerrjen e një flamuri në mënyrë arbitrare, thelluan edhe më shumë ndarjen.

Egjiptianët në Ballkan, edhe sot njihen me etnonimet e tyre, ndërsa publikisht njihen si Egjiptianë, dhe Ballkano Egjiptian, apo Egjiptian të Ballkanit. Grupi etnik i Egjiptianëve të Ballkanit, për shkak të autoktonisë në Ballkan, duhet të dalloj nga Egjiptianët e Egjiptit. Për të bërë dallim (distinction) në mes të Egjiptianëve të Egjiptit dhe Egjiptianëve që jetojnë në trevat e Ballkanit, krahas identifikimit me origjinën tonë si Egjiptian, paraqitet nevoja e identifikimit tonë edhe me Ballkanin.

Harresa etnike e pranishme te Egjiptianët në Ballkan ka bërë që ndjena etnike në komunitet të mos jetë shumë e fuqishme. Në kohën e globalizmit kjo do të ishte diçka e dobishme sikur në Ballkan të mos dominonte ambienti ku gjithçka matet me përkatësi etnike. Ndjenjat e pamjaftueshme etnike të komuniteti lenë si pasojë edhe vështirësitë në organizim të duhur të komunitetit si masë e duhur për të përmirësuar pozitën e keqe në vendet e Ballkanit.

Miratimi i simboleve tona që identifikojnë etninë tonë, do të krijonte një element të fuqishëm për përforsimin e ndjenjave etnike të komuniteti. Gjithashtu, identifikimi i unifikuar në Ballkan i të gjithë Egjiptianëve, do të eliminonte keqkuptimet brenda dhe jashtë komunitetit Egjiptian në Ballkan.

Miratimi i simboleve etnike dhe përdorimi i emërtimeve unik për të gjithë Egjiptianët e Ballkanit duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe me konsensus sa më të gjerë. Përfshirja e Egjiptianëve nga shtetet e Ballkanit dhe të Diasporës për miratimin e simboleve tona kombëtare dhe unifikimi i përdorimit të emërtimeve tonë etnik, nxjerr nevojën e organizimit të debatit që i paraprinë mbajtjes së Kongresit të Egjiptianëve të Ballkanit.

Qëllimi

Avancimi dhe promovimi i identitetit të Egjiptianeve në Ballkan, krijimi i platformes unike të veprimit dhe përfaqësimit me simbole dhe emërtim të unifikuar.

Objektivat

- Të rekomandohen për Kongres Simbolet Unike Identifikuese për Egjiptianët e Ballkanit
- Të debatohet dhe të rekomandohet për Kongres lidhur me emërtimin e unifikuar për Egjiptianët në G. Ballkanik
- Të krijohet një plan veprimi regional për promovimin dhe mbrojtjen e interesave të egjiptianëve në Ballkan.
- Të krijohet një strukturë mbi nacionale e mbrojtjes dhe avancimit të identitetit Egjiptian në Ballkan.

Aktivitetet

1. Aktivitetet për konsultime dhe për krijimin e Grupit Punues të Kongresit, me përfaqësuesit nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Diaspora.
2. Konkursi për simbolet etnike
3. Forumi zhvillon punimet me datën 23 dhe 24 Qershor 2014.

Draft Agjenda

23 Qershor 2014

12:00 Arritja e pjesëmarrësve dhe Akomodimi ne Hotel

13:45 Regjistrimi ne Forumin e Egjiptianeve te Ballkanit

14:00-17: 00 Sesiioni 1, Tryeza e Diskutimit “ Statusi Politik dhe Social i Egjiptianeve në Ballkan pas Kongresit te 90', arrijtet dhe sfidat !?”

18:30 21:00 Diskutimi dhe rekomandimi lidhur me Simbolet e Egjiptianëve në Ballkan

24 Qershor 2014

Sesioni 2

09:30-11:30 Tryeza Shkencore “ Letrnjoftim i Egjiptianëve të Ballkanit dhe emërtimi i drejt”

Sesioni 3

13:00-15-00 “Struktura organizative e Egjiptianëve në Ballkan dhe Agjenda 2020”

15:00-15:30 Mbyllja e Forumit

